

DEKRET
Nr. 250, datë 27.9.2023

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93, nenit 136, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 48, pika 13, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në vendimin nr. 474, datë 13.9.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. Valbon Çekrezi”, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Valbon Çekrezi emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj